



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR**

**VENDIM**  
**Nr. 14, Datë 26.07.2024**

**"Për miratimin e përbërjes së Nëngrupeve të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik"**

Bazuar në nenet 24 dhe 32 - 41 të Rregullores së Kuvendit dhe në pikën VIII dhe X të vendimit nr. 50/2024, datë 30.05.2024 të Kuvendit të Shqipërisë "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e ligjit dhe Antikorrupsionin për "Shqipërinë 2030" në Bashkimin Evropian", me propozim të Kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

**VENDOSI:**

1. Të administrojë dhe miratojë regjistrin me emrat e propozuar të ekspertëve dhe Sekretariatit Teknik dhe të dhëna të tjera të sjella në përgjigje të ftesës për bashkëpunim nga subjektet e interesuara për t'u angazhuar dhe kontribuar në këtë proces. *(Aneksi 1, bashkëlidhur këtij vendimi).*
2. Të administrojë dhe miratojë listën e propozimeve për ekspertë në Grupin e Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) dhe për Sekretariatit teknik (ST) bazuar në të dhënat e regjistrit të administruar si më sipër, në pikën 1, të këtij vendimi. *(Aneksi 2, bashkëlidhur këtij vendimi).*
3. Të miratojë përbërjen e Nëngrupeve të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë (Nëngrupet e GENL-së), të organizuara sipas 3 fushave të objektit të veprimtarisë së këtij komisioni propozuar nga institucionet e pavarura, shoqëria civile, universitetet publike e jo publike dhe komuniteti i biznesit. *(Aneksi 3, bashkëlidhur këtij vendimi).*
4. Të miratojë përbërjen dhe drejtimin e Sekretariatit Teknik, të cilët do të funksionojnë në mbështetje të Nëngrupeve të GENL-së, të organizuar sipas 3 fushave të objektit të veprimtarisë së këtij komisioni. *(Aneksi 4, bashkëlidhur këtij vendimi).*

5. Të miratojë listën e ekspertëve dhe profesionistëve të propozuar nga institucionet shtetërore (agjensitë ekzekutive ligjzbatuese, institucionet me risk ndaj korrupsionit, ministritë dhe institucionet e tyre të varësisë), të cilët do të atashohen dhe do të përfshihen në këtë proces në mbështetje dhe sipas kërkesave të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë. (*Aneksi 5, bashkëlidhur këtij vendimi*).
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**FATMIR XHAFAJ**



Miratuar më 26.07.2024